



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A.

Aksesi në rrjetin postar

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Ligjit 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” dhe të Rregullores për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar, ofruesi i shërbimit universal, në përputhje me parimet e mos diskriminimit dhe transparencës, mundëson akses në rrjetin postar, kurdohere dhe kudo që të jetë e mundur, për çdo ofrues të autorizuar nga AKEP dhe përdorues me shumice të shërbimeve postare që ka paraqitur një kërkesë me shkrim në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, në pikat e mëposhtme të aksesit:

- a) në ato pjesë të rrjetit postar ku kryhet përqendrimi i dërgesave postare nga pjesë të ndryshme të rrjetit të aksesit - për të gjitha objektet postare;
- b) në ato pjesë të rrjetit postar, ku objektet postare përgatiten për shpërndarje në pikat e rrjetit postar ku kryhet dorëzimi - për objektet postare të grupuara sipas destinacionit ose sipas adresave të marrësve, në mënyrën e kërkuar nga ofruesi i shërbimit universal.

Ofruesi i shërbimit universal mund të mundësojë akses me rrjetin postar në pjesë të tjera të rrjetit postar, me kusht që kjo të kryhet në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë rregullore.

Akses në rrjetin postar, nënkupton pranimin dhe përpunimin e objekteve postare në mënyrën e kërkuar nga ofruesi i shërbimit universal, dhe transportin e tyre deri në pikën e kontraktuar të aksesit në rrjetin postar, me qëllim transportimin e mëtejshëm dhe shpërndarjen në adresat e marrësve.

Ofruesi i shërbimit universal mban përgjegjësi në përputhje me dispozitat e Ligjit për shërbimin postar, për humbjen, dëmtimin e plotë ose zvogëlimin e përmbajtjes së dërgesave postare dhe për kalimin e afatit për dërgimin tek përdoruesi i aksesit, që nga momenti i pranimit të objekteve postare nga përdoruesit e aksesit deri në momentin e dorëzimit tek marrësi

Aksesi ndaj të dhënave të ofruesit të shërbimit universal

1. Aksesi ndaj të dhënave të ofruesit të shërbimit universal përfshin aksesin në:

- a) Sistemin e kodeve postare;
- b) Bazën e të dhënave për klasifikim e dërgesave postare;
- c) Të dhënat rreth ndryshimeve të adresës;
- d) Shërbimin e dërgimit të objekteve postare dhe shërbimin e kthimit të dërgesave postare tek dërguesit.

2. Aksesi në sistemin e kodit postar do të thotë mundësimi i aksesit për përdoruesit për të përdorur bazën e të dhënave lidhur me numrat dhe kodet postare të ofruesit të shërbimit universal.

3. Aksesi në bazën e të dhënave për klasifikim e dërgesave postare do të thotë mundësimi i aksesit për përdoruesit për të përdorur bazat e të dhënave përkatëse me qëllim grupimin e objekteve postare në mënyrën e duhur dhe aksesin në rrjetin postar.

4. Akses në të dhënat lidhur me ndryshimet e adresave për shërbimet e përcjelljes së objekteve postare dhe shërbimin e kthimit të objekteve postare tek dërguesit do të thotë mundësimi i aksesit për përdoruesit për të përdorur të dhënat ekzistuese, të mbledhura nga ofruesi i shërbimit universal, në lidhje me ndryshimet që kanë të bëjnë me adresat e marrësve të objekteve postare

Aplikimi për akses në rrjetin postar

Një përdorues i aksesit duhet të paraqesë një aplikim për akses në rrjetin postar

Aplikimi duhet të përmbajë:

- a) të dhënat e përdoruesit të aksesit (ekstrakt i regjistrimit në QKR përkatës i personave fizikë apo juridikë),
- b) listën e shërbimeve postare dhe vlerësimin e sasisë së objekteve postare me të cilin do të aksesojë rrjetin postar,
- c) vlerësimin e dinamikës së pranimin të objekteve postare,
- d) pikat e aksesit dhe mënyrën e qasjes në rrjetin postar,
- e) listën e të dhënave të përdorura për të kërkuar akses,
- e) fillimin dhe kohëzgjatjen e kontratës për akses në rrjetin postar.

Ofruesi i shërbimit universal i jep informacion përdoruesit të aksesit në lidhje me ekzistencën e kushteve të duhura teknike dhe teknologjike për akses në rrjetin postar, brenda 30 ditëve nga data e marrja e aplikimit të plotë.

Nëse ekzistojnë kushtet e duhura teknike dhe teknologjike, ofruesi i shërbimit universal është i detyruar t'i ofrojë përdoruesit të aksesit lidhjen e një Kontratë për akses në rrjetin postar brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në lidhje me ekzistencën e kushteve për akses në rrjetin postar.

Kontrata për akses në rrjetin postar

Në qoftë se aplikimi është në përputhje me kërkesat e përcaktuara, ofruesi i shërbimit universal duhet të nënshkruajë një kontratë për akses në rrjetin postar

Kontrata duhet detyrimisht të përmbajë të paktën elementet e mëposhtëm:

- a) Të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit universal dhe të përdoruesit të aksesit;
- b) Llojet e shërbimeve që do të ofrohen nga ana e përdoruesit të aksesit;
- c) Pikat e aksesit në rrjetin postar;
- d) Tarifat, mënyrën dhe afatet kohore të pagesës;
- e) Procedurën për ndryshimin e kontratës;

Standardet e cilësisë së ofrimit të shërbimit universal postar

Ofrimi i shërbimeve postare universale realizohet në përputhje me standardet europiane dhe ato boterore për shërbimet postare universale, të përcaktuara nga UPU-ja, si dhe me standardet e përcaktuara nga AKEP në këte rregullore.

- Standarti 85% i shpërndarjes ndërmjet qyteteve D+1(ditën e nesërme të mbërritjes)
- Standarti 95 % i shpërndarjes brenda qytetit D+1(ditën e nesërme të mbërritjes)
- Standarti 60% i shpërndarjes ndërmjet fshatrave D+2(ditën e nesërme të mbërritjes)

Çdo ofrues i autorizuar i shërbimit postar është i ftuar të paraqesë aplikimin për akses në rrjetin postar sipas kriterëve të përcaktuara për të nënshkruar kontratën me Postën Shqiptare.